



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI**

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë, Tel. 04 257 – 924

Nr. 190/7 Prot.

Tiranë më 30.06.2016

V E N D I M

Nr. 78, Datë 30.06.2016

PËR

EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË AUTORITETIN E AVIACIONIT CIVIL (AAC) "MBI ZBATIMIN E LIGJSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË SË VEPRIMTARISË EKONOMIKO FINANCIARE".

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit i Departamentit të Auditimit të Investimeve dhe Projekteve me Financim të Huaj dhe Shoqërive Publike, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e kontrollit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, në mbështetje të neneve 15 dhe 25 të ligjit nr.154/2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit: Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë, së veprimtarisë ekonomiko financiare" për periudhën 01.01.2014 deri më 31.12.2015, të ushtruar në AAC .

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH me shkresën nr.1073/7, datë 31.03.2014, rezultoi se nga 60 rekomandime gjithsej të dërguara, nga AAC janë vlerësuar dhe realizuar gjithsej 50 rekomandime ose në masën 83%, ku nga

41 masa organizative të rekomanduara 33 masa janë realizuar, 2 masa janë në proces realizimi dhe 6 masa nuk janë realizuar. Gjithashtu nga 3 masa shpërblim dëmi të rekomanduara me vlerë gjithsej 8,996 mijë lekë janë realizuar 2 masa me vlerë 8,696 mijë lekë dhe një masë nuk është realizuar në vlerën 300 mijë lekë. Nga 16 masa disiplinore të rekomanduara, rezultoi se këto janë zbatuar plotësisht (*trajtuar në faqet 10-20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandojmë:

-Nga AAC të merren masat për ndjekjen dhe realizimin e plotë të rekomandime të përcaktuara plotësisht, të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së me shkresën nr.1073/7, datë 31.03.2014.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi

Nga auditimi i disa praktikave për pajisjen me Licencë PPL (H) për pilot privat dhe praktikave me zgjedhje të dhënies së licencave për rinovim të licencës së inxhinierit të avionit apo të mirëmbajtjes së avionit, rezultoi se një pjesë e dokumentacionit të paraqitur nga aplikantët ishin dokument fotokopje (trajnimet me ekspertë të huaj, regjistri mbi orët e fluturimeve, apo te shërbimeve te helikopterëve). Këto dokumente kanë rëndësi shumë të madhe në gjykimin mbi eksperiencën e aplikantit, janë kërkesa në plotësim të standardeve ndërkombëtare, kusht për dhënien e licencave për pilot apo mirëmbajtje pavarësisht se janë të kushtëzuara dhe nuk janë për transport ajror publik. Referuar faktit të rëndësisë të procesit të konfirmimit të dokumentacionit specifik të kërkuar, pavarësisht deklaramit nga AAC që për raste të dyshuara, nga ky autoritet bëhen verifikimet përkatëse, me qëllim që ky proces të jetë sa më transparent dhe lehtësisht i auditueshëm (*trajtuar në faqet 105-110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*), ***rekomandojmë:***

- Nga AAC të pranohet dokumentacioni nga aplikanti mbi bazën e një procesverbali, ku të listohen të gjitha dokumentet e paraqitura dhe deklarimi i aplikantit për vërtetësinë e dokumentit të paraqitur.

- Për dokumentacionin fotokopje të paraqitur dhe të pa konfirmuar ligjërisht si të njëjtë me origjinalin, nga AAC të kërkohej që ky dokumentacion të shoqërohet me shkresa zyrtare të institucioneve, ku të konfirmojnë vërtetësinë e dokumentacionit fotokopje, pjesë e veprimtarisë së tyre (regjistra për orë fluturimi të aplikantit pilotë, apo orë shërbimi apo riparimi për aplikantët për licencën e mirëmbajtjes). Për certifikata trajnimit të kryerjes nga pilotet por të paraqitura nga aplikantët në formën fotokopje në pamundësi për tu paraqitur origjinale, të bëhen verifikimet përkatëse dhe të lihen gjurmë në dosjen e inventarizuar të aplikantit për procesin e verifikimit të saktësisë dhe vërtetësisë së dokumentit.

-Nga AAC për efekt të gjykit mbi plotësimin e kërkesave të aplikantit për marrjen e licencës përkatëse, të hartohen “Check list” ku të ketë rubrika dhe ndarje të tyre në mënyrë të tillë, që të merret informacioni për plotësimin e kërkesave bazike të aplikantit për përfitim të licencës si dhe paraqitja e dokumentacionit suplementar që i jep kredite plus aplikantit. Këto rubrika të jenë të dallueshme nga njëra tjetra.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi

Gjatë vitit 2014 dhe 2015 janë kryer sponsorizime dhe financime në shumën 1,050,000 lekë në kundërshtim me ligjin nr.7892, datë 21.12.1994 “Për sponsorizimet” i ndryshuar në një kohë që KLSH në auditimin e mëparshëm, me shkresën nr. 1073/7 datë 31.03.2014 “Dërgim

raporti përfundimtar dhe rekomandime” ka lënë rekomandim masë organizative ndalimin e sponsorizimeve si veprime në kundërshtim me ligjin (trajtuar në faqet 48-65të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

-Nga Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues të mos kryhen propozime dhe vendimmarrje në lidhje me financimin apo sponsorizimit e institucioneve të tjera shtetërore apo private, në kundërshtim me kompetencat e përcaktuara në ligjin për AAC dhe aktet e tjera në fuqi. Veprimtaritë e financuara jashtë funksioneve ligjore të AAC i ngarkon me përgjegjësi ligjore dhe të shpërblimit të efekteve financiare.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi

Janë rimbursuar punonjësit dhe një pjesë e anëtarëve të Këshillit Drejtues për pagesa për telefoninë celulare në shumat gjithsej 1,925,905 lekë për vitin 2014 dhe shuma 2,208,226 lekë për vitin 2015, në kundërshtim me vendimin e KM nr.864, datë 23.07.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celularë të personave Juridikë, Publikë”.

Gjithashtu është konstatuar se nga marrëveshja kontraktuale me kompaninë [REDAKTUAR] për shërbimin e telefonisë, janë përfituar telefon celularë falas në shumën 2,014,900 lekë, të cilat rezultuan të mos jenë bërë hyrje dhe përfshirë në kontabilitet, në kundërshtim me udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “ Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Nga ana e AAC është prishur përpara afatit kontraktual të amenduar, kontrata me kompaninë [REDAKTUAR] dhe për të cilën AAC me këtë kompani është në proces gjykimi. Nga kompania [REDAKTUAR] pretendohet shlyerja e vleftës prej 2,014,900 lekë për aparatet falas të përfituar nga lidhja e kontratës, si dhe shuma prej 1,307,671 lekë e përfituar nga lehtësirat e tarifave, referuar sanksioneve të vendosura në kontratë, (trajtuar në faqet 48-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

1-Nga AAC të merren masa që të ndërpritet rimbursimi i shumave për punonjësit e AAC dhe anëtarëve të Këshillit Drejtues të cilat bien në kundërshtim me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 864, datë 23.07.2010. Procesi i rimbursimit për kategoritë përfituese (IIa dhe IIb) të bëhet deri në limitet e përcaktuara në vendimin e mësipërm.

Menjëherë

2-Të bëhet ndryshimi i përgjegjësi në pagesat e faturave për periudhën në vazhdim, nga AAC tek punonjësit e saj, kundrejt dakortësisë së punonjësve për marrjen e shërbimit me paketat përfituese aktuale, apo të kërkuara për shërbimin përkatës, meqenëse AAC si institucion ka lidhur kontratë me kompaninë [REDAKTUAR], me periudhë të shkurtër kohore, ku aktualisht paraqitet mundësia e këtyre ndryshimeve.

Menjëherë

3-Nga AAC të ndiqen të gjitha shkallët e gjykimit për padinë e hapur nga kompania [REDAKTUAR], si rezultat i prishjes së njëanshme të kontratës nga AAC. Në rastin e përfundimit të procesit të gjykimit në humbje të AAC dhe me përcaktime dëmi, nga AAC të analizohet përgjegjësia dhe të shpërblehet shuma e përcaktuar nga vendimi i gjykimit sanksion në dëm të personave përgjegjës.

Në vazhdim

4-Nga Drejtoria Ekonomike e AAC në zbatim të udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011, të realizohet hyrja në magazinë e celularëve të përfituar falas nga lidhja e kontratës me Kompaninë [REDAKTUAR], për pagimin e faturave të shërbimit për vitet 2014 dhe 2015

nga AAC dhe të kryhet kontabilizimi i shumës 2,014,900 lekë, vlerë e aparateve celulare të dhuruar, konform përcaktimeve në kontratë dhe amendamenteve të saj. Dhënia në përdorim e celularëve të bëhet sipas rregullave të përcaktuara në udhëzimin e mësipërm.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi

Nga auditimi rezultoi se gjatë vitit 2014 nga ana e AAC është Certifikuar “Operatori i [REDAKTUAR]” si operator i ofrimit të shërbimit të lundrimit ajror, referuar nenit 79/1 të ligjit nr. 10040, datë 22.12.2008 “ Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”. Për këtë certifikim, nga AAC nuk është arkëtuar asnjë tarifë për arsye se në udhëzimin e përbashkët të MTI dhe MF me nr. 2225, datë 13.05.2013 “Për përcaktimin e Tarifave të Shërbimeve në Aviacionin Civil” ka specifikim tarife vetëm për licencim “Licencë e operimit [REDAKTUAR]” në shumën 150,000 Euro dhe jo certifikim. Megjithatë nga AAC ka iniciativë dhe vendimmarrje të KD (vendimi nr. 41, datë 30.07.2014 i KD të AAC “ Për propozimin e disa ndryshimeve në udhëzimin nr.2225, datë 13.05.2013) nga MTI nuk ka miratim në këtë drejtim.

Referuar dhe faktit të konstatuar se udhëzimi i përbashkët i MTI dhe MF me nr. 2225, datë 13.05.2013 “Për përcaktimin e Tarifave të Shërbimeve në Aviacionin Civil” në tabelat bashkëlidhur ka pasaktësi në vendosjen e njësive të matjes në 000/lekë apo lekë, duke rezultuar sipas njësive matëse të vendosura, në shumë raste, në tarifa që dalin jashtë gjykimit të tarifimit, gjë që e bën të domosdoshëm rishikimin e këtij udhëzimi për efekt të saktësisë, por dhe të rishikimit të tarifave të vendosura, (trajtuar në faqet 25-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit), **rekomandojmë:**

-Nga AAC të merren masat e nevojshme dhe miratimet përkatëse për ndryshimin e udhëzimit të përbashkët nr.2225, datë 13.05.2013, si për saktësimin e njësive matëse të vlerave të vendosura në lidhjet përkatëse bashkëlidhur, të cilat bëhen shkak për keq interpretime, ashtu dhe për parashikimin e tarifave të rezultuara të nevojshme në procesin e shqyrtimit dhe licencimit, certifikimit, miratimit të dokumentacionit konform kërkesave dhe parashikimeve të legjislacionit në fuqi. Nga AAC në këtë proces të realizohet dhe ndryshimi i tarifave të cilat në kushtet aktuale, për stimulimin e tregut vendas, duhet të jenë konkurruese.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi

Nga auditimi i veprimtarisë së organeve drejtuese të AAC rezultoi se me Vendimin nr.44, datë 27.10.2014, Këshilli Drejtues ka vendosur në detyrën e sekretarit të këshillit një punonjëse të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, në kundërshtim me rregulloren e miratuar nga vetë Këshilli Drejtues me Vendimin nr.1, datë 05.08.2010.

Në disa raste Këshilli Drejtues, me propozim të Drejtorit Ekzekutiv, ka marrë vendime për transferimin pa pagesë të aktiveve të institucionit, pa u shoqëruar këto vendime me relacionet përkatëse nga institucioni si dhe pa u pasqyruar e plotë mbështetja ligjore, Udhëzimi nr.30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” neni 57, 108. Gjithashtu gjatë viteve objekt auditimi ka vendimmarrje nga Këshilli Drejtues dhe për rimbursime shpenzimesh për punonjësit e AAC apo financime e sponsorizime për institucione të tjera në kundërshtim me aktet ligjore në fuqi, (trajtuar në faqet 20-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

1-Të rishikohet dhe të miratohet nga Këshilli Drejtues rregullorja për veprimtarinë e tij, pasi rregullorja ekzistuese është e vitit 2010, duke përcaktuar në këtë rregullore emërimin e sekretares të këtij këshilli dhe detyrat e saj.

Vazhdimisht

2-Vendimet e Këshillit Drejtues, të merren duke pasur relacione të sakta nga administrata e autoritetit dhe bazë ligjore të plotë për zbatimin e tyre, si dhe baza ligjore të pasqyrohet me saktësi dhe gjithëpërfshirëse në këto vendime.

Vazhdimisht

7. Gjetje nga auditimi

Me Urdhrin nr.138, datë 01.04.2015 dhe nr.141, datë 03.04.2015 të Drejtorit Ekzekutiv janë emëruar respektivisht dy punonjëse me detyrë sekretare dhe asistente të Drejtorit Ekzekutiv, pozicione këto jo të miratuara në strukturën aktuale. Si mbështetje ligjore në këtë urdhrë është cituar neni 13 i ligjit nr.10233, datë 11.02.2010 “Për AAC”, ligj i cili ka ndryshuar dhe ka hyrë në fuqi në Janar të vitit 2015, ku neni i cituar në këto urdhra është shfuqizuar.

Gjithashtu, me urdhrat e Drejtorit Ekzekutiv nr.139, 142, 143, datë 02.04.2015 janë punësuar dhe 8 punonjës mirëmbajtje në Aeroportin e Kukësit, mbi strukturën e miratuar nga MTI. Efekti negativ financiar për këto vendime është në vlerën **2,905,000 lekë** (trajtuar në faqet 65-70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Nga Drejtori Ekzekutiv në zbatim të akteve ligjore në fuqi për kompetencat e miratimit të strukturës organizative të AAC dhe Aeroportit të Kukësit të ndiqen të gjithë procedurat për paraqitjen dhe miratimin e nevojave për ndryshime të nevojshme strukturore, sipas kompetencave dhe miratimeve të përcaktuara në ligjin për AAC dhe aktet e tjera në fuqi.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi

Nga auditimi i strukturës organizative të AAC ka rezultuar se në këtë institucion emërimi i punonjësve është bërë në zbatim të ligjit nr.10233, datë 11.02.2010 “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, sipas Kodit të Punës dhe rregullores së brendshme për rekrutimin e punonjësve të AAC, e hartuar kjo në bashkëpunim me partnerët e huaj. Më hyrjen në fuqi të VKM nr. 100, datë 26.02.2014, që ka përcaktuar strukturën e AAC dhe miratimit të ligjit për statusin e nëpunësit civil, ka rezultuar se jo të gjithë punonjësit e AAC, sipas pozicioneve aktuale të vendit të punës i është konfirmuar statusi i nëpunësit civil, në një kohë që 13 punonjësve i është refuzuar statusi nga DAP-i në fund të vitit 2015. Me marrëveshje midis AAC dhe DAP është rënë dakord ngritja e një komisioni për vlerësimin e dosjeve hap pas hapi të punonjësve të pakonfirmuar apo të refuzuar. Gjithashtu, nga AAC referuar dhe mangësive të rezultuara si në strukturën organike, ashtu edhe mos përfundimit të procesit të pranimit të statusit të nëpunësit civil për gjithë punonjësit, nuk ka përfunduar miratimi i rregullores së re të përshtatshme dhe në përputhje me strukturën organike aktuale të miratuar (trajtuar në faqet 65-70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

1-Nga Drejtori Ekzekutiv dhe Drejtoria e Administratës dhe e Shërbimeve të merren masat që në bashkëpunim dhe sipas dakortësisë me DAP –in, të përfundojnë procesin e vlerësimit të dosjeve të punonjësve të AAC dhe përputhshmërinë me kërkesat e vendit të punës, për pasojë konfirmimin ose jo të statusit të nëpunësit civil.

Duke pasur në konsideratë rëndësinë e pozicioneve të punës në AAC për vetë procesin dhe funksionet që kryen AAC, në zbatim të ligjit për Kodin Ajror në Republikën e Shqipërisë si dhe nevojën e vazhdueshme të punonjësve të saj për të qenë të trajnuar periodikisht, konform standardeve ndërkombëtare dhe për të arritur kredencialet e përcaktuara në aktet dhe urdhrat në fuqi sipas kërkesave të vendit të punës, nga dy institucionet të hartohet një plan veprimi konkret për përfundimin e këtij procesi brenda afateve kohore sa më të afërta të vitit

2016. Përfundimi i këtij procesi i hap rrugën shpalljes dhe plotësimit të vendeve vakant aktuale dhe të mundshëm, të krijuar nga procesi i konfirmimit të statusit të nëpunësit civil. 2-Të ngrihet grupi i punës për hartimin dhe miratimin e ndryshimeve të rregullores së brendshme të funksionimit të AAC në zbatim të strukturës aktuale të miratuar në fuqi.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi

Gjatë auditimit të pagesave nëpërmjet bankës ka rezultuar se janë paguar punonjësit për vitin 2014 nga muaji Prill dhe vitin 2015, për pension profesional në kundërshtim me detyrimet e institucionit për këto pagesa të parashikuara në aktet ligjore në fuqi për sistemin e sigurimeve në RSH i ndryshuar nën 5/2, dhe Ligjin për AAC, pasi në asnjë nga këto akte nuk përcaktohet limiti dhe miratimi i shumave të mundshme për rimbursim nga Institucioni. Këto shuma i janë paguar kompanisë [REDAKTUAR], në shumën 7,532,543 lekë për vitin 2014 dhe 12,700,563 lekë për vitin 2015 dhe përqindjet e financuara për punonjës kanë qenë në masën 16.7% të pagës në vitin 2014 dhe 18-25 % në vitin 2015. Referuar ndryshimeve ligjore të hyra në fuqi gjatë vitit 2015 për ligjin e AAC dhe për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë, konform dhe përcaktimit ligjor në nenin 5/2 të ligjit nr.104/2014, datë 11.12.2014” Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7703, datë 11.05.2014” Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, ku theksohet se “Krijimi, veprimtaria dhe mbikëqyrja e fondeve profesionale dhe fondeve të pensionit vullnetar bëhen sipas ligjit të veçantë” si dhe përcaktimit në nenin 8 të ligjit 168/2014 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10233, datë 11.02.2010 “Për AAC” të ndryshuar ku kompetenca për përcaktimin e pagave të punonjësve, brenda kufirit minimal e maksimal të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave, në vartësi të mundësive financiare të institucionit është nga Këshilli i Drejtues dhe pas miratimit nga Ministri (trajtuar në faqet 48-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

1-Nga AAC referuar kompetencave ligjore për miratim, parashikuar në nenin 8 të ligjit të ndryshuar të AAC, brenda mundësive të financimit dhe hapësirave të kufijve minimal dhe maksimal të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave për pagat e punonjësve të Institucionit, të krijohet fondi për financimin e “ pensionit profesional” si dhe përqindja e pjesëmarrjes së financimit nga institucioni në këtë pension profesional, duke marrë miratimet përkatëse sipas kompetencave ligjore.

Menjëherë

2-Këto pagesa të kryhen nga AAC vetëm pas miratimeve përkatëse konform kërkesave ligjore dhe të trajtohen si të ardhura të punonjësve duke derdhur për to tatimin mbi të ardhurat në rastet e tejkallimit të kufijve të vendosur në nenin 88/4 dhe 88/5 të ligjit nr.10197, datë 10.12.2009” Për fondet e pensioneve vullnetare” .

Në vazhdim

3-Nga AAC, për pagesat për pension profesional prej 7,532,543 lekë për vitin 2014, dhe 12,700,563 lekë për vitin 2015, për efekt të llogaritjes së tatimit mbi të ardhurat dhe derdhjes së tyre sipas procedurave të miratuara, për financimet e realizuara sa më sipër, të kryen llogaritjet për punonjësit e AAC, referuar tejkallimit të kufijve të vendosur në nenet 88/4 dhe 88/5 të ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi

Nga auditimi i kryer në AAC në drejtim të llogaritjes së kostonë së tarifës en-route është konstatuar se kosto e llogaritur nga ky institucion, në ndryshueshmëri me llogaritjen e saj nga [REDAKTUAR] sha, nuk ka pasur në konsideratë standardet IAS/IFRS-ve, i përcaktuar ky detyrim në

ligjin nr. 8821, datë 15.10.2001 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare të Eurokontroll-it”, në artikullin 1 të kësaj konvente, “germa e” dhe në udhëzuesin e Eurokontrollit “Parimet për përcaktimin e kostos bazë për pagesat gjatë udhëtimeve në korridoret ajrorë dhe për llogaritjen e kurseve të njësisë”. Gjithashtu u konstatua se nga AAC llogaritja e normave të amortizimit të aktiveve të saj është bazuar në normat e amortizimit që aplikohen për institucionet buxhetore, në një kohë që nga [REDAKTUAR] sha, janë llogaritur normat e amortizimit bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IAS/IFRS). Ky fakt ka ndodhur në një kohë që kostoja e AAC dhe e [REDAKTUAR] sha konsolidohet dhe paraqitet si një njësi kostoje në Eurokontroll në bazë të nenit 17/ 2 (trajtuar në faqet 34-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

1-Autoriteti i Aviacionit Civil duhet të marrë masa për aplikimin e Standardeve Ndërkombëtare për mbajtjen e llogarive dhe Raportimit Financiar (IAS/IFRS), duke bërë dhe unifikimin me [REDAKTUAR] sha.

2-Drejtoria Ekonomike duhet të bëjë propozimet përkatëse për miratim në KD në drejtim të miratimit të normave të amortizimit konform standardeve IAS/IFRS, të cilat specifikohen në mënyrë konkrete në udhëzuesin e Eurokontroll-it cituar mësipër, si dhe të përcaktojë mënyrën e llogaritjes së tyre, duke përfshirë dhe të gjitha parashikimet e tjera në lidhje me koston në këtë udhëzues.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi

Nga auditimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2015 ka rezultuar se nga AAC ka një fond të pa konsumuar nga veprimtaria e vitit ushtrimor (tepricë) në shumën 42,886,455 lekë dhe gjatë viteve të mëparshme kjo tepricë është 37,759,969 lekë, në total në fund të vitit shuma në vlerën 80,646,424 lekë. Gjithashtu ka rezultuar se në AAC është miratuar vendimi i Këshillit Drejtues nr.39 datë 25.06.2014 që përcakton krijimin e një fondi rezervë dhe që në vendimin e KD nr.46, datë 1.12.2014 “Për miratimin e Programit Ekonomik të vitit 2015” ky fond rezervë është parashikuar në masën 83,817 mijë lekë, vendime që bien në kundërshtim me kompetencat e KD të përcaktuar në ligjin nr. 10233 datë 11.02.2010 “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, të ndryshuar neni 5,6 si dhe me nenin 18/2,18/3 (trajtuar në faqet 34-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Nga AAC pas miratimit të Pasqyrave Financiare të vitit 2015 nga Këshilli Drejtues të realizohet derdhja në Buxhetin e Shtetit e shumave të papërdorura të konsoliduara në fund të vitit 2015, duke zbritur shpenzimet e angazhuara për tremujorin e parë të vitit 2016, konform përcaktimit në ligjin për AAC.

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi

Nga auditimi është konstatuar se në AAC nuk ishte përditësuar regjistri kontabël i aktiveve që zotëron ky institucion, apo ka në administrim, në kundërshtim me pikën 26 të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”. Gjithashtu në kontabilitet nuk është përfshirë inventari i vlerësuar i aktiveve të aeroportit të Kukësit, i përfituar si një donacion i i qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe, megjithëse ky aeroport është marrë në administrim që në vitin 2006 me VKM nr. 343 datë 07.06.2006 “Për pronësinë dhe administrimin e aeroportit të Kukësit”, veprime në kundërshtim me pikën 57 të udhëzimit të mësipërm i cili kërkon vlerësimin e aktiveve, kur dhurohen në sasi pa kosto apo çmim (trajtuar në faqet 34-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

1-Drejtoria Ekonomike të marrë masat për përditësimin e regjistrit kontabël në zbatim të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik".
2-Nga Titullari i AAC të autorizohet vlerësimi i aktiveve të marra si donacion në aeroportin e Kukësit, në përputhje me parashikimet dhe procedurat e akteve ligjore në fuqi.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi

Nga auditimi u konstatua se gjatë vitit 2014 është paguar ndaj Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, shuma 344,788 lekë si një detyrim i prapambetur për sigurime shoqërore e shëndetësore për periudhën 2010. Nga shqyrtimi i dokumentacionit u vërejt se ky detyrim kishte lindur si pasojë e një gabimi të bërë nga [REDAKTUAR], si pasojë e kalimit të kësaj shume në llogarinë e DRTT me deklarinë shumën 291,121 lekë, në vend të kalimit në llogarinë e sigurimeve shoqërore. Ky veprim ka sjellë një efekt financiar negativ në vlerën 251,051 lekë, si dhe interesa në vlerën 93,000 lekë (trajtuar në faqet 47-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Nga Drejtoria Ekonomike të merren masa për rakordimet e duhura me Drejtorinë Rajonale Tatimore, Tiranë për përdorimin e shumës së paguar tepër për kompensimin e detyrimeve të ardhshme tatimore.

Menjëherë

14. Gjetje nga auditimi

Referuar faktit se nga AAC është lidhur kontratë me ekspert kontabël për auditimin ligjor të Pasqyrave Financiare për vitin 2013, 2014, dhe ku në kushtet kontraktuale të kontratave të lidhura janë vendosur orë pune në masën 250 orë, të cilat janë të planifikuara, por jo të argumentuara për tejkalimin e tyre, në referencë me normativat e orëve të punës të vendosura si limite në aktet ligjore (trajtuar në faqet 34-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit),
rekomandojmë:

Drejtoria Ekonomike të marrë në konsideratë e të shqyrtojë në mënyrë aktive kushtet që përcaktohen në kontrata konsulence dhe ekspertize të fushës financiare duke shfrytëzuar normativa të përdorura dhe të argumentuara për çdo orë pune eksperti në procesin e certifikimit, për një përdorimin me ekonomikitet dhe efikasitet të burimeve financiare të institucionit.

Menjëherë

15. Gjetje nga auditimi

Nga auditimi u konstatua se punonjësit e AAC-se si dhe AAC si institucion, nuk janë përfshirë në listën e institucioneve që përfshihen në skemën e sigurimeve suplementare, konform procedurave të parashikuara në ligjin nr. 8097, datë 21.03.1996 "Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit", i ndryshuar, ligjin nr. 9990 datë 15.09.2008, neni 1 pika 9, si dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr.489, datë 21.09.2000 pikat 3 dhe 4 (trajtuar në faqet 48-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Nga AAC të ndiqet sipas kompetencës ligjore kërkesa për përfshirjen e saj nga Këshilli i Ministrave, në listën e institucioneve të miratuara për kryerjen e pagesave të sigurimeve suplementare, konform ligjit.

Menjëherë

16. Gjetje nga auditimi

Referuar faktit të konstatuar në AAC se për tre auto veturat e blera gjatë vitit 2014, (■■■■ AA 415 IZ, ■■■■ AA 527 IZ, ■■■■ AA 516 IZ) janë ndryshuar normativat e konsumit të karburantit konform konstatimeve të komisioneve të ngritura nga titullari, me procesverbalet e datës 14.04.2014 dhe datës 23.07.2014, ku normativa është rritur nga 5.2 l/100km në 13 litra/100km për automjetet ■■■■ dhe nga 9.6l/100km në 15 litra /100km për automjetin ■■■■, në një kohë që automjetet e reja të blera ishin brenda periudhës së garancisë dhe një nga specifikimet teknike të mjeteve ishte dhe normativa e konsumit të karburantit. Gjithashtu u konstatua se nga strukturat përkatëse në AAC nuk ka reagim konform kompetencave për reklamim të konstatimit të mospërputhshmërisë me një nga specifikimet teknike të tenderit, por në mënyrë të heshtur është vazhduar me aplikimin e normativave të konstatuara nga komisionet duke shkaktuar një efekt financiar për periudhën objekt auditimi nga veprimet dhe mosveprimet konform procedurave që parashikon ligji, në shumën **1,766,112 lekë** (trajtuar në faqet 34-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

- 1-AAC të marrë masat për përcaktim të normativave të sakta të karburantit me ekspert të jashtëm të fushës, për të nxjerrë deviacionin real nga specifikimet teknike të kontraktuara.
- 2- Nga AAC të merret në analizë problematika dhe të nxirren përgjegjësitë për efektet negative ekonomike të krijuara institucionit nga mos ushtrimi i të drejtës për garancinë e automjeteve në lidhje me mospërputhjet që rezultuan nga konsumi i karburantit për mjetet e blera.
- 3- Për efekt të mbikëqyrjes dhe kontrollit të përdorimit të karburantit me efektivitet, nga AAC të miratohet dokumentacioni standard për përdorimin e karburantit për çdo mjet dhe çdo distancë të përshkruar (fletë udhëtimeve) konform përcaktimeve dhe rregullave në fuqi. Gjithashtu kontrolli i dokumentacionit për kilometrat e përshkruara, herë pas here të verifikohet dhe me përputhshmërinë e kilometrave të regjistruara në aparaturat matëse të mjetit.

Menjëherë

17. Gjetje nga auditimi

Gjatë auditimit të rregullshmërisë së dokumentacionit justifikues së harxhimit të karburantit (mbajtjes së fletë udhëtimeve dhe saktësia dhe rregullshmëria e tyre) u konstatuan parregullsi në plotësimin nga drejtuesit e mjeteve, ku janë vendosur distanca kilometrike jo sipas përcaktimeve në Urdhrin e Ministrit të PPT(sot MTI) nr.125, datë 26.12.2011 (në fuqi) “Për miratimin e hartave të azhornuara të Rrjetit Rrugor Kombëtar dhe distancave kilometrike ndërmjet qyteteve në RSH”, si dhe konstatime të udhëtimeve në qytetin e Vlorës, të Sarandës, etj. të paautorizuara nga Titullari i Institucionit, për të cilat nga drejtuesit e mjeteve janë tërhequr karburant naftë në mënyrë të padrejtë **në shumën 244,110 lekë** (trajtuar në faqet 34-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Nga Autoriteti i Aviacionit Civil, në të ardhmen të ndiqen të gjitha procedurat e përcaktuara në udhëzimet përkatëse të Ministrisë së Financave për menaxhimin e aktiveve të institucionit, në drejtim të furnizimit dhe identifikimit të konsumit të karburantit, me miratimet sipas kompetencave dhe dokumentet justifikuese, konform kërkesave të akteve në fuqi. Mos argumentimi i konsumit të karburantit me të gjithë dokumentacionin ligjor i ngarkon me përgjegjësi materiale përdoruesit e tij.

Vazhdimisht

18. Gjetje nga auditimi

-Rregjistri i prokurimeve, nuk është hartuar duke pasqyruar të gjitha prokurimet e kryera, në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu V “Zhvillimi i procedurave” pika 1/c.

-Njësia e Prokurimit, për vitet 2014-2015, në përfundim të çdo procedure prokurimi për çdo dosje, nuk ka kryer inventarizimin e saj, në përputhje me nenin 30, Modeli nr. 8 “Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë”, miratuar nga DP e Arkivave, në zbatim të neneve 3 e 29 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për Arkivat”.

-Hedhja e kriterëve të kualifikimit për procedurat e prokurimit në sistemin elektronik, është kryer në një folder të vetëm pa specifikuar të ndarë kriteret e veçanta të kualifikimit, veprim i cili nuk i jep mundësinë komisionit të vlerësimit të ofertave, për të vlerësuar çdo kriter në veçanti, në kundërshtim me udhëzimin e Agjencisë së Prokurimit Publik “Mbi hedhjen në sistem të një procedure prokurimi”.

-Në dokumentet e tenderit të hartuara e miratuara nga Autoriteti Kontraktor, nuk është argumentuar vendosja e çdo kriteri për kualifikim, në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.1.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu V, pika 2, germa “a”(trajtuar në faqet 70-101 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

1-Autoriteti kontraktor, të marrë masa për trajnimin e vazhdueshëm të anëtarëve të Njesisë së Prokurimit, nëpërmjet trajnimeve në Agjencinë e Prokurimit Publik, në përmbushje të kërkesës së VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me qëllim përmirësimin e punës së Njesisë së Prokurimit për pasqyrimin e saktë të prokurimeve të kryera në regjistrin e prokurimeve, paraqitjen e specifikuar të çdo kriteri kualifikues në sistemin elektronik, inventarizimin e dosjeve, etj.

Vazhdimisht

2-Njësia e Prokurimit, të marrë të gjitha masat, që kërkesat kualifikuese të veçanta, të hartohen në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit, të përcaktohen kriteret kualifikimi të sakta dhe të kuptueshme, pa lënë shteg për interpretime si dhe të detajohen sipas rregullave të prokurimit publik.

Vazhdimisht

19. Gjetje nga auditimi

Në kriteret e veçanta për kualifikim në disa procedura prokurimi të vitit 2014 “*kapaciteti ekonomik dhe financiar*”, janë kërkuar kopje të balanceve të miratuara nga organet tatimore të viteve 2011 dhe 2012 dhe nuk është kërkuar bilanci i vitit të fundit që është viti 2013, duke mos lejuar pjesëmarrjen e operatorëve të tjerë ekonomikë në konkurrim, veprim në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu III, pika 3/c (trajtuar në faqet 70-101 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Autoriteti Kontraktor, të hartojë kërkesa të veçanta për kualifikim, që të sigurojë konkurrencën e nevojshme, si një nga parimet bazë të prokurimit në blerjen e mallrave, shërbimeve dhe punimeve, për të arritur rezultate të dëshirueshme në përdorimin me efektivitet të fondeve publike.

Vazhdimisht

20. Gjetje nga auditimi

Janë zhvilluar procedura “me negociim pa shpallje”, kryesisht për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike, me pretendimin se nuk është koha e mjaftueshme për zhvillimin e procedurës

me mjete elektronike. Zgjedhja e kësaj procedure dhe përcaktimi se negociimi do të vazhdojë deri në lidhjen e kontratës nga procedura elektronike është në kundërshtim me nenin 36 “procedura me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës” i VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku citohet se “Neglizhenca apo vonesat në fillimin e procedurave normale të prokurimit, nuk janë shkaqe që argumentojnë zbatimin e kësaj procedure”. Autoriteti kontraktor ka pasur në dispozicion kohën e nevojshme për kryerjen e procedurave normale të prokurimit elektronik, sepse urdhrat e prokurimit për procedurën e hapur elektronike janë nxjerrë në fund të muajit shkurt (trajtuar në faqet 70-101 Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Autoriteti kontraktor të marrë të gjitha masat, për prokurimin e shërbimeve dhe mallrave në sistemin elektronik të APP, ta fillojë në kohën e duhur, për të mundësuar shmangien e procedurës së prokurimit “me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës” me qëllim përdorimin me efektivitet, ekonomikitet dhe eficientë të fondeve publike.

Vazhdimisht

21. Gjetje nga auditimi

Nga titullari i autoritetit kontraktor nuk janë ngritur komisione për marrjen në dorëzim të mallrave të furnizuara, apo shërbimeve për çdo rast të procedurës së prokurimit me vlerë të vogël, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” (trajtuar në faqet 48-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Të merren masa nga Titullari i AAC-së për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të aktiveve të furnizuar për çdo rast të blerjes apo shërbimit të kryer me procedurë prokurimi me vlerë të vogël, në zbatim të akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

Në vazhdimësi

22. Gjetje nga auditimi

Nga AAC për vitin vitit 2015 nuk janë hartuar dokumenti i deklaratës së vetëvlerësimit dhe raporti i cilësisë së funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm, i cili duhej të dërgohej zyrtarisht në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës dhe në Ministrinë e Financave, për efekte të plotësimit me rigorozitet të kërkesave të nenit 18 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, nisur nga fakti se këto dokumente japin opinione të rëndësishme mbi funksionimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit brenda institucionit dhe ndryshimet esenciale në këtë sistem nga viti në vit (trajtuar në faqet 101-105 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Nga AAC deklaratimet për periudhat në vazhdim, të bëhen në institucionet përkatëse brenda muajit Shkurt të vitit pasardhës, në plotësim të kërkesave ligjore, të dorëzojë pyetësin e vetëvlerësimit për funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit së bashku me deklaratën dhe raportin e cilësisë.

Vazhdimisht

23. Gjetje nga auditimi

Në AAC nuk kishte rregulla të brendshme të miratuara për gjurmët e auditimit për procedurat standarde të përdorimit të fondeve buxhetore, për shpenzimet për paga, operative sipas llojit, për administrimin e aseteve dhe materialeve të institucionit si dhe të procedurave të

prokurimit publik. Me synim që të sigurohet se të gjitha operacionet e njësive publike, dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm e të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrolli (*trajtuar në faqet 101-105 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*), **rekomandojmë:**

Nga Nëpunësi Autorizues dhe Titullari i institucionit, ku aktualisht në AAC nëpunësi autorizues është dhe Titullari i institucionit, në zbatim të nenit 9, pika 2 dhe nenit 16, pika 2, të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, të hartohen dhe të miratohen rregullat për gjurmët e auditimit, për procedurat standarde të shpenzimeve, sipas udhëzimeve të nxjerra nga Ministria e Financave në zbatim të ligjit të MFK.

Menjëherë

24. Gjetje nga auditimi

Nga AAC nuk është përcaktuar koordinator i riskut apo deleguar pozicioni i tij, nuk ka një regjistër risku dhe strategji risku të miratuar, nuk ka të përcaktuar nga titullari procedura të brendshme të anti korrupsionit dhe të sinjalizimit të parregullsive, veprime këto në kundërshtim me nenet 8,10,17,21 të ligjit nr. 102 96, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, për efekt të konsolidimit dhe të funksionimit të sistemit të instaluar në institucion konform rregullave dhe kërkesave ligjore mbi funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm (*trajtuar në faqet 101-105 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*), **rekomandojmë:**

1-Nga AAC të krijohet regjistri i riskut institucional dhe referuar risqeve të mundshme të hartohet dhe miratohet sipas kompetencave strategjia e riskut me qëllim realizimin e objektivave institucionale vjetore e afatmesëm.

2-Nga titullari i institucionit të përcaktohen procedura të brendshme anti korrupsion dhe të sinjalizimit të parregullsive konform kuadrit ligjor në fuqi.

Menjëherë

25. Gjetje nga auditimi

1. Nga auditimi i kryer në AAC rezultoi se një pjesë e fondeve menaxhohej për ruajtjen fizike të ambienteve të këtij institucioni si dhe të ambienteve të Aeroportit të Kukësit. Gjithashtu u konstatua se dokumentacioni i cili vërtetonte kryerjen e shërbimit nuk jepte në mënyrë bindëse se ky shërbim kryhej konform të gjitha specifikimeve dhe kërkesave të vendosura në procedurën e tenderimit për shërbimin e ruajtjes fizike (*trajtuar në faqet 70-101 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për efekt të rritjes së përgjegjshmërisë në kryerjen e shërbimit të ruajtjes fizike për ambientet e kontraktuara si dhe të procesit të mbikëqyrjes së këtij shërbimi në cilësinë dhe konform kërkesave të specifikuara në kontratë, referuar dhe faktit se AAC është përgjegjëse e sigurisë në zbatim të përcaktimeve në nenin 105 të ligjit nr.10040, datë 22.12.2008 “Kodi Ajror në Republikën e Shqipërisë” për rrjedhojë dhe mbikëqyrëse dhe cilësisë së sigurisë zbatuar nga Koncesionari, konformë përcaktimeve në Marrëveshjen Koncesionare, **rekomandojmë:**

- Nga AAC për rritjen e përgjegjshmërisë dhe cilësisë së shërbimit të ruajtjes fizike të ambienteve në administrim të saj, të përcaktojë rregulla të brendshme strikte për mbikëqyrjen e këtij shërbimi, ku nga punonjësit përgjegjës të mbikëqyrjes për efekt të transparencës dhe auditimit të dokumentohen gjurmët e kësaj mbikëqyrjeje.

-Nga strukturat përkatëse të AAC të intensifikohen auditimet në Aeroportin “Nënë Tereza” në drejtim të mbikëqyrjes së sigurisë së transportit ajror dhe marrjes së masave në përputhje me përcaktimet në Kodin Ajror të RSH.

Menjëherë

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi

Nga auditimi ka rezultuar se nga AAC nuk janë bërë hyrje dhe përfshirë në kontabilitet telefonat celularë të përfituar sipas kontratës së lidhur me kompaninë [REDAKTUAR] dhe amendamenteve të saj, në vlerën 2,014,900 lekë në kundërshtim me udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” si dhe për faktin se nuk u konfirmua ekzistenca e tyre (trajtuar në faqet 48-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

-Nga Autoriteti i Aviacionit Civil në rastin e mungesës së aseteve telefonë celularë të markave dhe vlerave të përcaktuara në kontratën e lidhur me kompaninë [REDAKTUAR] dhe amendamenteve të saj, (pra me pamundësi bërje hyrje në institucion) të ndiqen të gjitha rrugët ligjore (nxirret urdhri) për shpërblimin e dëmit, të kryhen kontabilizimet për arkëtimin e **shumës 2,014,900 lekë sipas përgjegjësi dhe përcaktimeve në kontratën e lidhur.**

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi

Nga auditimi i pagesave për shpërblimet ka rezultuar se pagesa e bërë për shpërblimin e anëtarëve të këshillit drejtues, është në kundërshtim me VKM nr.776, datë 24.09.2010 “Për caktimin e shpërblimit të kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit Drejtues të AAC”, dhe në kundërshtim dhe me ligjin nr.10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve” neni 4 “Kompetencat e Këshillit të Ministrave” pika 3 .Vlera e këtij shpërblimi është gjithsej **590,750 lekë** (trajtuar në faqet 65-70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

-Nga Autoriteti i Aviacionit Civil, të ndiqen të gjitha rrugët ligjore (nxirret urdhri) për shpërblimin e dëmit, të kryhen kontabilizimet dhe të bëhet arkëtimi i shumës së shpërblimit të marrë nga kryetari dhe anëtarët e Këshillit Drejtues me vlerë gjithsej **590,750 lekë**, nga personat përfitues, sipas përcaktimeve në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi

Nga auditimi është konstatuar se është riparuar gjatë vitit 2015 Automjeti Skoda Super B 1.8 TSI me targë AA 404 DV nga [REDAKTUAR] shpk ne vleren 1,068,000 lekë, kjo me procedure prokurimi te drejtpërdrejte ne kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”, vendimin KM nr.918, datë 29.12.2014 ‘Për rregullat e prokurimit Publik”, udhëzimin APP nr.3, datë 27.01.2015 “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël”, ne një kohë që kishte një vlerësim nga [REDAKTUAR] shpk. me shkresën datë 31.10.2014 ku mjete merrej përsipër të riparohet nga kjo kompani në vlerën 977,021lekë për 20 ditë. Për diferencën e riparimit me shumë në vlerën **90,078 lekë mban përgjegjësi** njësia e prokurimit për blerjet me vlerë të vogël e përbërë nga **K.S** kryetar, **O.A** anëtar, **Y.S** anëtar që kanë zbatuar procedurën e rasteve emergjente (trajtuar në faqet 48-65 te Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

-Nga Autoriteti i Aviacionit Civil të ndiqen të gjitha rrugët ligjore (nxirret urdhri) për shpërblimin e dëmit, të kryhen kontabilizimet për arkëtimin e **shumës 90,078 lekë** nga njësia e prokurimit me vlerë të vogël z. **K.S**, z. **O.A**, z.**Y.S** në masën prej 30,026 lekë secili si përgjegjës në shkaktimin e dëmit.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi

Në likuidimin e shpenzimeve për biletë udhëtimi me pagesën e faturës nr.78, datë 11.09.2014 për agjencinë [REDAKTUAR], ka rezultuar një penaltet prej 485 Euro si rezultat i ndryshimit të datës dhe orës së udhëtimit të përcaktuara këto ndryshime në faturën e paraqitur nga agjencia. Referuar faktit se për këtë ndryshim nuk ka asnjë dokument argumentues apo justifikues bashkëlidhur praktikës së likuidimit si nga Nëpunësi Autorizues që ka konsumuar shërbimin ashtu dhe nga Nëpunësi Zbatues dhe Autorizues që kanë realizuar pagesën (*trajtuar në faqet 47-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*), **rekomandojmë:**

-Nga Autoriteti i Aviacionit Civil, të ndiqen të gjitha rrugët ligjore (nxirret urdhri) për shpërblimin e dëmit, të kryhen kontabilizimet dhe të bëhet arkëtimi i shumës **prej 485 Euro** nga personat përgjegjës **z.F. B** dhe **z.F.G.**

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi

Referuar faktit të konstatuar të detyrimeve debitore nga arkëtimet për shërbimet e kryera nga AAC deri në fund të vitit 2015 të kontabilizuar, por të pa likuiduar deri në Maj të vitit 2016, të dy klientëve të mbartur nga viti 2014 me detyrime të pashlyera, Operatori [REDAKTUAR] për faturën nr. 78 date 07.10.2014 me vlere 25,000 leke dhe operatori [REDAKTUAR] për dy fatura, faturën nr. 39 date 7.03.2014 me vlere 25,000 leke dhe faturën nr. 84 datë 22.10.2014 me vlerë 25,000 leke për fluturime ferry, për të cilët nuk ka arkëtim, megjithëse ka kaluar afati një vjeçar i lindjes së detyrimeve si dhe nuk ka vendimmarrje institucionale për këto operatore, (*trajtuar në faqet 32-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*), **rekomandojmë:**

Nga AAC të ndiqen të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin **e shumës gjithsej 75,000 lekë, nga të cilat 25,000 lekë** nga operatori [REDAKTUAR] për faturën nr. 78, datë 07.10.2014 të pa likuiduar dhe **shuma 50,000 lekë** nga operatori [REDAKTUAR] për dy fatura, Faturën nr. 39 date 7.03.2014 dhe faturën nr.84 datë 22.10.2014 të pa likuiduar për fluturimet ferry të realizuara prej tyre.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi

Shtesa e kontratës e nënshkruar për vitin 2014, me objekt shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike të AAC me shoqërinë [REDAKTUAR], është 14,494 lekë/muaj me tvsh, më e lartë se kontrata e vitit 2013. Në këto kushte shoqëria ka përfituar **më tepër 24,157 lekë**

Gjithashtu kontrata me objekt shërbimi i sigurisë fizike të AAC, është nënshkruar në datën 03.03.2014, me vlerë 166,000 lekë, ose 900 lekë/muaj më tepër 2,700 lekë pa tvsh, ose 3, 240 lekë me tvsh, likuiduar më tepër shoqëria [REDAKTUAR] (*trajtuar në faqet 70-107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandojmë:

-Nga Autoriteti i Aviacionit Civil, të ndiqen të gjitha rrugët ligjore për shpërblimin e dëmit, të kryhen kontabilizimet dhe të bëhet arkëtimi i shumës gjithsej **27,397 lekë**, nga të cilat **24,157 lekë** shoqëria [REDAKTUAR] përfituar padrejtësisht nga kontrata shtesë për kryerjen e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike të AAC, për nevojat e fillim vitit dhe shumës **3,240 lekë** nga shoqëria [REDAKTUAR] përfituar padrejtësisht nga kontrata e datës 03.03.2014 për kryerjen e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike të AAC.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE

C1. Mbështetur në nenin 59 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", dhe VKM nr. 115, datë 05.06.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil", i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të AAC të urdhërojë fillimin e procedurave përkatëse për dhënien e masës disiplinore sipas VKM nr.115, datë 05.03.2014 dhe ligjit nr.152/2013" Për nëpunësin civil":

-“ Mbajtja 1/3 e pagës së plotë për një periudhë 6 mujore ” neni 58, germa b në bazë të analizës për rezultatet e auditimit të paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit në AAC për:

1. z. F. G me detyrë Nëpunës Zbatues i AAC për arsye se:

- Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e pagesave nëpërmjet bankës për telefoninë celulare në kundërshtim me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 864, datë 23.07.2010 “Për pajisjen me numra telefoni celularë të personave Juridikë, Publikë” pika 13 , lidhja nr. 6 si dhe pika 9 referuar nivelit të pagës së marrë të baras vlefshme me përcaktimet në vendim. Sipas këtij vendimi rimbursimi duhet të bëhet vetëm për kategoritë:

1.Drejtor i Përgjithshëm Kategoria IIa shuma 10, 000 lekë

2.Zëvendës Drejtor; Drejtor Drejtorie kategoria II b shuma e rimbursuar 4,000 lekë.

Aktualisht janë rimbursuar

1. Drejtor Ekzekutiv 30,000 lekë

2. Zëvendës Drejtor;Drejtor Drejtorie 7,000 lekë

3. Përgjegjës sektori 5,000 lekë

4. Inspektor specialist shoferë me shumën 3,000 lekë.

Dhënë në kundërshtim me vendimin sa mësipër shuma 4,134,134 lekë, për punonjësit dhe 274305 për anëtarët e Këshillit Drejtues. Kjo përgjegjësi e përcaktuar në funksion të detyrimeve si NZ në zbatim të ligjit për MFK

- Për lejin e dhënies së sponsorizimeve dhe financimeve në kundërshtim me ligjin nr.7892, datë 21.12.1994 “Për sponsorizimet” i ndryshuar, në nenin 3 theksohet se: Sponsorizues në kuptim të këtij ligji janë vetëm subjektet që kanë cilësinë e tregtarit, qofshin këta persona fizikë ose juridikë, vendas, të huaj a me kapital të përbashkët në këndvështrimin e detyrimeve të NZ sipas nenin 12, pika 3/a, dh, e të ligjit nr.10296, datë 8.07.2010 “Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Gjithashtu në ligjin nr. 10479, datë 0.11.2011 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10233, datë 11.0.2010 “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, në nenin 18, pikat 3 theksohet se: “ Veprimtaria e Autoritetit financohet tërësisht nga të ardhurat e realizuara nga vetë ai. Të ardhurat e realizuara, por të pashpërndara në fund të vitit të parë buxhetor të veprimtarisë, mbarten për vitin pasardhës dhe reflektohen në nivelin e tarifave. Në vitet në vazhdim, të ardhurat e realizuara e të papërdorura, deri në fund të vitit, mbarten e përdoren për shpenzime të angazhuara deri për një periudhë 3-mujore të vitit pasardhës e më pas derdhen në Buxhetin e Shtetit.”. Në këtë kontekst fondet të cilat teprojnë nga programimi i aktivitetit të AAC për periudhën sipas përcaktimit në nenin 18 të ligjit duhet të derdhen në buxhetin e shtetit.

Këto financime dhe sponsorizime janë kryer në një kohë që në auditimin e kaluar KLSH me shkresën nr. 1073/7 datë 31.03.2014”Dërgim raporti përfundimtar dhe rekomandime” ka lënë rekomandim “Masë organizative” ndalimin e sponsorizimeve si veprime në kundërshtim me ligjin.

- Për shkelje procedurash në shpenzimet e realizuara nëpërmjet bankës për shpenzimet e kryera për vitin 2015 dhe mungesë dokumentacioni justifikues për disa raste sipas trajtimit hap pas hapi në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

- Për lejimin e kryerjes së pagesave në këndvështrimin e detyrimeve të NZ sipas nenin 12, pika 3/a, dh, e të ligjit nr.10296, datë 8.07.2010 “Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin” për pension profesional të punonjësve në shumat prej 7,532,543 lekë për vitin 2014 të dhënë në kundërshtim me ligjin në fuqi dhe pagesat prej 12,700,563 leke për vitin 2015, ku me ndryshimet ligjore, janë dhënë pa marre miratimet përkatëse, konform kompetencave dhe procedurave ligjore të miratuara, duke shkaktuar dem ekonomik për vitin 2014 dhe efekt financiar negativ për vitin 2015. Gjithashtu, mos llogaritje dhe mosmbajtje të detyrimeve të tatimit mbi të ardhurat për këto financime, konform kufijve të vendosur në nenin 88/4 dhe 88/5 të ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009.

-Për shkeljet e konstatuara gjatë auditimit të pagesave të kryera me bankë për vitin 2014, ku Autoriteti i Aviacionit Civil më datë 21.08.2014 ka paguar ndaj Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, shumën 344,788 lekë si një detyrim i prapambetur për sigurime shoqërore e shëndetësore për periudhën 2010. Nga shqyrtimi i dokumentacionit u vërejt se ky detyrim kishte lindur si pasojë e një gabimi të bërë nga [REDAKTUAR], pasi gabimisht ka kaluar në llogarinë e Tatimeve me Deklarim shumën 291,121 lekë në vend që të kalonte tek llogaria e sigurimeve shoqërore. Ky veprim nga Drejtoria Ekonomike e AAC nuk është rakorduar me Drejtorinë Rajonale Tatimore, Tiranë por është paguar për herë të dytë detyrimi.

-Për shkeljet e konstatuara gjatë auditimit të procedurave të inventarizimit të aktiveve të institucionit, ku rezultoi se inventarizimi i aeroportit të Kukësit është bërë pa vlera kontabël. Megjithatë ky aeroport është marrë në administrim që në vitin 2006 me VKM nr. 343 datë 07.06.2006 “Për pronësinë dhe administrimin e aeroportit të Kukësit”, si një donacion i Qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe, gjatë gjithë kësaj periudhe nuk është kryer asnjëherë një vlerësim i aseteve të tij, kjo gjë në kundërshtim me nenin 57 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

(Sa mësipër janë mbajtur procesverbalet me nr. 3, datë 19.04.2016, nr.4 datë 19.04.2016, nr. 5 datë 19.04.2016 dhe nr. 7 datë 20.04.2016.

–“Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet” neni 58, germa c, për :

2.z. F. B me detyrë ish Drejtor Ekzekutiv i AAC për arsye se:

-Gjatë kontrollit të pagesave nëpërmjet bankës për vitin 2014 [REDAKTUAR] në pozicionin e Drejtorit Ekzekutiv të AAC ka nxjerrë urdhrin nr. 449, datë 21.07.2014, për blerjen me vlerë 805,000 lekë, të materialeve të furnizimit të sallës së mbledhjeve. Blerja është kryer pa u zbatuar procedurat ligjore të prokurimeve, nuk është nxjerrë urdhri i prokurimit, përcaktimi i fondit, ngritja e komisionit të vlerësimit si dhe njësia e prokurimit, veprime në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

-Për shkeljet e konstatuara në auditimin e konsumit të karburantit për periudhën objekt auditimi për mos kryerjen e veprimeve për ushtrimin e të drejtave që vijnë nga kontrata e lidhur me [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], lidhur me mospërputhjet (tejkallimet) e konsumit të karburantit për automjetete e blera në mars 2014.

Referuar dokumentacionit në dizpozicion, konstatohet se nga titullari [REDAKTUAR], nuk është vepruar ndaj faktit se automjetet kanë konsumuar shumë më tepër se normativat e përcaktuara në specifikimet teknike dhe patentën shoqëruese të mjeteve.

Në kushtet e kontratës së lidhur me [REDAKTUAR], specifikohet qartë në: Nenin 12. “Testimet dhe Inspektimet”, pika 5 ku citohet: “As ekzekutimi i testeve as inspektimi i mallrave nuk do të çlirojë Kontraktuesin nga çdo garanci ose detyrim tjetër sipas kontratës”, Neni 17: “Garancitë”, pikat 2 dhe 8, citohet: “Shitësi (Kontraktuesi) **mban përgjegjësi për çdo defekt ose mospërputhje që ekziston në momentin kur rrisku kaloi tek Autoriteti Kontraktor, edhe kur defekti shfaqet pas këtij momenti.**”, “Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor humbet të drejtën për të kundërshtuar për të metat e sendit në se ai nuk e ushtron të drejtën e tij brenda dy vjetësh nga data kur sendet i janë dorëzuar atij, po qe se ky afat nuk bie në kundërshtim me kohëzgjatjen e garancisë kontraktore”. Efekti negativ për periudhën objekt auditimi i mosveprimeve të mësipërme është në vlerën 1,766,112 lekë.

(Sa mësipër janë mbajtur procesverbalet me nr. 7, datë 20.04.2016, nr.9 datë 20.04.2016)

C2. Mbështetur në nenin 58 “llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, nenit 57, nenit 59 të ligjit, gjithashtu mbështetur në pikën 11 të VKM nr. 115, datë 05.06.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil”, si dhe ligjin nr. 9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikes në administratën publike”, i rekomandojmë Titullarit të AAC të filloj procedurat për dhënien e masës disiplinore:

“Vërejtje” neni 58, germa a për:

1.z. A. K me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Administratës dhe Shërbimeve për arsye se:

Për periudhën objekt auditimi nuk ka mbikëqyrur mbajtjen dhe administrimin konform akteve në fuqi të dokumentacionit të konsumit të karburantit nga punonjësit në vartësi të Drejtorisë, në kundërshtim me përgjegjësitë dhe detyra e përcaktuara ku theksohet: “Sugjerimi /përcaktimi i procedurave për praktikat operacionale dhe administrative në përputhje me ligjet dhe procedurat në fuqi”; “Të mbikëqyrë zbatimin e procedurave dhe të kryejë kontrollin e cilësisë së punëve të kryera nga secili prej sektorëve të Drejtorisë dhe specialistëve që ajo mbulon”.

(Sa mësipër është mbajtur procesverbali me nr. 8, datë 20.04.2016)

C3. Mbështetur në nenin 58 “llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, nenit 57, nenit 59 të ligjit, gjithashtu mbështetur në pikën 11 të VKM nr. 115, datë 05.06.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil”, si dhe ligjin nr. 9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikes në administratën publike”, i rekomandojmë Eprorit direkt të filloj procedurat për dhënien e masës disiplinore:

“Vërejtje” neni 58, germa a për:

1.znj. E.Sh. me detyrë specialiste në Drejtorinë e Administratës dhe Shërbimeve për arsye se:

Për shkeljet e konstatuara në auditimin e konsumit të karburantit për periudhën objekt auditimi në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara në Urdhërin e brendshëm nr. 455, datë 23.07.2014 të drejtorit ekzekutiv “Për limitin mujor të karburantit” si dhe pikën 36 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” ku citohet “Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose

administrative. Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eliminojnë mundësinë për gabime, harresa, numërim të dyfishtë si dhe atë të mashtrimeve.

-Nga specialistja e shërbimeve në Drejtorinë e Administratës dhe Shërbimeve, znj. **E. Sh.** nuk janë kryer verifikimet për konfirmimet e personave përdorues të automjeteve, kilometrat e shënuar në fletë udhëtime, urdhrat për udhëtimet jashtë qytetit të Tiranës, konsumi i karburantit në lidhje me kilometrat dhe normën e shënuar në fletë udhëtime.

(Sa më sipër është mbajtur procesverbali me nr. 8, datë 20.04.2016)

Për kompetencë të Agjencisë së Prokurimit Publik

A. MASA ADMINISTRATIVE/DISIPLINORE

I. Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në procesverbalet përkatës dhe pjesës së Raportit Përfundimtar të Auditimit, mbështetur në nenin 13 dhe 72 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, pikës 3, kreut X të VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, neni 79 kreu XI, të ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet Administrative” dhe bazuar në nenin 15 të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë** titullarit të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe të fillojë procedurat për dhënien e masave administrative ose disiplinore:

A. Për Njësinë e Prokurimit

1.A.S., anëtar i njësisë së prokurimit

2.O.A., anëtar i njësisë së prokurimit

3.K. S., anëtar i njësisë së prokurimit për shkelje të konstatuara e të pasqyruara në Raportin Përfundimtar të Auditimit:

-Nga *Njësia e Prokurimit* në përfundim të çdo procedure prokurimi dhe për çdo dosje nuk është kryer inventarizimin e saj, në përputhje me dispozitat ligjore për arkivat.

-Në dokumentet e tenderit të hartuara e miratuara nga AK, për të gjithë tenderat e zhvilluar nuk kanë argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim

-Për shtesën e kontratës në masën 20%, për nevojat e fillim vitit, me objekt “*Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike të AAC për vitin 2014*”, AK nuk kanë kërkuar dokumentacionin ligjor operatorit ekonomik [REDAKTUAR] të ftuar për lidhjen e kontratës, për të vërtetuar besueshmërinë ekonomike.

-nuk kanë përcaktuar drejt në urdhrin e prokurimit bazueshmërinë ligjore për kryerjen e procedurës e cila nuk përputhet me përcaktimet ligjore në ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe VKM nr.1, datë 10.01.2007.

-Në njoftimin e kontratës të datës 08.01.2014, citohet se kontrata është nënshkruar në datën 31.12.2013, ndërsa kontrata rezulton të jetë nënshkruar në datën 07.01.2014 në shumën 308,815 lekë me tvsh, me afat nga 01.01.2014 - 20.02.2014. Kontrata është nënshkruar me fuqi prapavepruese, në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006.

Shtesa e kontratës e nënshkruar për vitin 2014, megjithëse nuk kalon masën e 20% të vlerës së kontratës së vitit 2013, është 14,494 lekë/muaj me tvsh, më e lartë se kontrata e vitit 2013. Në këto kushte shoqëria [REDAKTUAR] ka përfituar më tepër 24,157 lekë.

➤ Në tenderin e zhvilluar me objekt “*Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike të AAC*”.

-Nuk kanë hartuar kritere të drejta për kualifikim, sepse në përcaktimin e kritereve të veçanta për kualifikim, pika 2, “kapaciteti ekonomik dhe financiar”, kanë kërkuar që numri i punonjësve të siguroar nga operatorët ekonomik pjesëmarrës për vitin 2012, të jetë jo më pak se 20 punonjës, vërtetimi nga Drejtoria e Policisë së Qarkut për punonjësit e certifikuar jo më pak se 20 punonjës dhe leje për armatim jo më pak se për 20 punonjës, në një kohë që AK për kryerjen e këtij shërbimi ka kërkuar vetëm 5 punonjës.

Këto kërkesa bien në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

-Si pasojë e anulimit të tenderit për mangësi në kriteret e kualifikimit të hartuara nga njësia e prokurimit, për periudhën shkurt - qershor 2014, si pasojë e mosrealizimit të tenderit dhe anulimit janë zhvilluar procedura “me negociim pa shpallje paraprake” dhe shtesë kontrate në masën 20%,

-Nga njësia e prokurimit nuk janë analizuar shkaqet e anulimit të procedurës dhe të nxjerrin përgjegjësitë, në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007.

➤ Në tenderin e zhvilluar me objekt “Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike të AAC”,

-Për realizimin e këtij shërbimi, nuk kanë ftuar operatorin ekonomik [REDAKTUAR] i cili ka realizuar kontratën e vitit 2013 dhe kontratën shtesë në masën 20% të kontratës së vitit 2013.

-Në procesverbalin e negociimit nuk kanë nënshkruar pjesëmarrësit në negociim si edhe nuk ka gjurmë për negociimin e vlerës së kontratës.

-Nuk kanë kërkuar dokumentacionin ligjor që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë pjesëmarrës, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 33 dhe VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu V, pika 4 “Hapja dhe vlerësimi i ofertave”.

- kanë kërkuar sigurimin e kontratës vetëm për 1 muaj, dhe jo për të gjithë periudhën e kontratës

-nuk kanë argumentuar ligjërisht përdorimin e procedurës “negocim pa shpallje paraprake”, përdorimi i kësaj procedure është bazuar në nenin 33, pika 2/c të ligjit nr. 9643, datë 21.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe pikës 5/a, paragrafi i tretë Kreu IV i VKM, të një rasti si nevojë ekstreme, nuk është i bazuar sepse autoriteti kontraktor e ka pasur në dispozicion kohën e nevojshme për të kryer procedurat e prokurimit.

➤ Në tenderin e zhvilluar me objekt “Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike të AAC”,

-kanë kryer hedhjen e kritereve të kualifikimit në sistemin elektronik, në një folder të vetëm pa specifikuar të ndarë kriteret e veçanta të kualifikimit.

Kjo e metë është konstatuar pothuajse në të gjitha tenderët e realizuar dhe të specifikuar rast pas rasti në analizimin e mangësive të rezultuara në procedurat e prokurimit publik në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

-Në kriteret e kualifikimit të hartuara e miratuara nga AK me procesverbalin e datës 27.02.2014, kanë kërkuar “Kapaciteti teknik” kontratë për furnizime të së njëjtës natyrë në një vlerë prej 40% e vlerës që prokurohet, realizuar gjatë 3 viteve të fundit, në një kohë që objekti i prokurimit është tender shërbimi dhe jo blerje mallrash, në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007

-Në dokumentet e tenderit kanë përcaktuar si datë publikimi datën 28.03.2014, ndërsa data e hapjes së tenderit është data 10.03.2014.

➤ Në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje mjete transporti për nevojat e AAC”,

-kanë filluar procedurën e prokurimit pa pasur kërkesën për nevojat e mjeteve.

-Në kriteret e veçanta për kualifikim “kapaciteti ekonomik dhe financiar” kanë kërkuar kopje të bilanceve të viteve 2011 dhe 2012 dhe jo kopje të bilancit të vitit të fundit 2013 pasi periudha e tenderit është viti 2014.

-Kërkohet që afati i lëvrimit të makinave të jetë 2 javë pas nënshkrimit të kontratës, kriter i cili kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi, ashtu si edhe ka ndodhur ku në këtë tender është paraqitur vetëm 1 operator ekonomik.

➤ Në tenderin e zhvilluar me objekt *“Blerje Karburante për nevoja të AAC-së”*,

-nuk u kanë kthyer përgjigje apo liruar sigurimet e ofertave operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në konkurrim, të cilët nuk janë shpallur fitues.

-Në kriteret e veçanta për kualifikim kapaciteti teknik, kanë kërkuar që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të kenë të paktën 2 pika karburanti brenda qytetit të Tiranës dhe nga 1 pikë në qytetet Korçë, Shkodër, Tiranë, Vlorë. Përcaktimi i kërkesave të tilla, kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi, ashtu si edhe ka ndodhur ku në këtë tender janë paraqitur vetëm 2 operatorë ekonomikë.

➤ Në tenderin e zhvilluar me objekt *“Blerje Pajisje Kompjuterike për nevoja të AAC-së”*,

4. E. Sh anëtar i njësisë së prokurimit

-kanë filluar procedurën e prokurimit pa pasur kërkesën dhe argumentimin për nevojat e mallrave dhe pajisjeve.

Gjatë vitit 2014, janë kryer transferime kapitale në Ministrinë e Transportit pikërisht 17 kompjuterë, 20 printera, 4 printerë me ngjyra, etj, në datën 27.10.2014 ndërkohë që janë kryer blerje të tjera dhe nuk ka asnjë argumentim të nevojave dhe kërkesa për domosdoshmërinë e prokurimit të mallrave të mësipërm.

Në kontratën e nënshkruar nga palët dhe dokumentacionin shoqërues të saj, kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, specifikimet teknike, etj, konstatohet se nuk kanë përcaktuar në kushtet e veçanta pikërisht kushtin e paraqitjes së këtyre certifikatave në momentin e dorëzimit të mallit.

➤ Në tenderin e zhvilluar me objekt *“Blerje Pajisje Kompjuterike për nevoja të AAC-së”*,

-kanë filluar procedurën e prokurimit pa pasur kërkesën për nevojat e mallrave dhe pajisjeve,

5.A.Gj anëtar i njësisë së prokurimit

6.Y. S anëtar i njësisë së prokurimit

-Për vitin 2015, në përfundim të çdo procedure prokurimi dhe për çdo dosje nuk kanë kryer inventarizimin e saj.

-Në dokumentet e tenderit të hartuara e miratuara nga AK, nuk kanë argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim.

➤ Në tenderin e zhvilluar me objekt *“Blerje Karburante për nevoja të AAC-së për vitin 2015”*

-Në kriteret e veçanta për kualifikim *“kapaciteti ekonomik dhe financiar”* kanë kërkuar kopje të bilanceve të viteve 2012 dhe 2013. Periudha e tenderit është viti 2015 dhe njësia e prokurimit nuk ka kërkuar bilancin e vitit të fundit që është viti 2014, si edhe është kërkuar që operatorët ekonomikë të kenë të paktën 3 pika karburanti brenda Tiranës dhe nga një pikë karburanti në çdo qark të vendit, gjithsej 14 pika karburanti, duke mos lejuar pjesëmarrjen e operatorëve të tjerë ekonomikë në konkurrim

➤ Për shërbimin me objekt *“Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike të AAC”*,

-Nuk kanë kërkuar sigurimin e kontratës në masën 10% të vlerës së kontratës

-Për shtesën e kontratës në masën 20%, për nevojat e fillim vitit, nuk kanë kërkuar dokumentacionin ligjor operatorit ekonomik [REDACTED] të ftuar për lidhjen e kontratës, për të vërtetuar besueshmërinë ekonomike.

-Nuk kanë ndjekur procedurën për njoftimin e operatorit ekonomik,

-Baza ligjore e përcaktuar në urdhrin e prokurimit, nuk përputhet me përcaktimet ligjore në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu IV “Llojet dhe përzgjedhja e procedurës”.

-Për kryerjen e shërbimit, njësia e prokurimit është mjaftuar vetëm me nxjerrjen e urdhrin të prokurimit, pa kërkesë për lindjen e nevojës së këtij shërbimi.

➤ Tenderi me objekt “Shërbimi i Ruajtjes dhe Sigurisë Fizike të Godinës së AAC-së”, -Sipas urdhrin të prokurimit nr.12, datë 11.02.2015, është zhvilluar procedura “me negociim pa shpallje”, ku citohet se me përfundimin e kontratës shtesë nuk është koha e mjaftueshme për zhvillimin e procedurës me mjete elektronike. Zgjedhja e kësaj procedure dhe përcaktimi se negociimi do të vazhdojë deri në lidhjen e kontratës nga procedura elektronike është në kundërshtim me nenin 36 “procedura me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës” i VKM nr.914, datë 29.12.2014

-Në dokumentet e tenderit, kriteret e veçanta për kualifikim “kapaciteti teknik”, kanë kërkuar që operatorët ekonomikë të paraqesin kontrata për furnizime të ngjashme të së njëjtës natyrë prej 40% të vlerës që prokurohet ...etj, në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 28 “Kontratat e shërbimeve” ku citohet ...për shërbime të ngjashme të kryera, në këtë rast procedura është për prokurim shërbimesh dhe jo mallrash.

-Sigurimi i kontratës datë 12.02.2015, në shumën 26,929 lekë, në shoqërinë e sigurimeve [REDAKTUAR].

Kontrata është nënshkruar në datën 12.02.2015, me afat deri në lidhjen e kontratës me mjete elektronike dhe vlerë mujore 269,286 lekë. Kanë kërkuar sigurimin e kontratës për 1 muaj. Kontrata ka zgjatur nga data 12.02.2015 - 29.06.2015, ose 4 muaj e 15 ditë dhe operatorit ekonomik [REDAKTUAR], nuk i kanë kërkuar sigurimin e kontratës për periudhën 3 muaj e 15 ditë.

➤ Për shërbimin me objekt “Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike të Aeroportit të Kukësit”, janë zhvilluar 3 procedura prokurimi, si më poshtë:

-Për shtesën e kontratës në masën 20%, për nevojat e fillim vitit, AK nuk ka kërkuar dokumentacionin ligjor operatorit ekonomik [REDAKTUAR] të ftuar për lidhjen e kontratës, për të vërtetuar besueshmërinë ekonomike.

-Nuk është ndjekur procedura për njoftimin e operatorit ekonomik.

-Baza ligjore e përcaktuar në urdhrin e prokurimit, nuk përputhet me përcaktimet ligjore në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe VKM nr.1, datë 10.01.2007.

-Për kryerjen e shërbimit, AK është mjaftuar vetëm me nxjerrjen e urdhrin të prokurimit, pa kërkesë për lindjen e nevojës së këtij shërbimi.

-Mungon sigurimi i kontratës në masën 10% të vlerës së kontratës, ose në shumën 205,507 lekë, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 58 “Njoftimi i fituesit dhe nënshkrimi i kontratës” dhe VKM nr.1, datë 10.01.2007 .

➤ Në tenderin me objekt “Shërbimi i Ruajtjes dhe Sigurisë Fizike të Aeroportit të Kukësit”,

-Sipas urdhrin të prokurimit nr.18, datë 27.02.2015, është zhvilluar procedura “me negociim pa shpallje”, ku citohet se me përfundimin e kontratës shtesë nuk është koha e mjaftueshme për zhvillimin e procedurës me mjete elektronike. Zgjedhja e kësaj procedure dhe përcaktimi se negociimi do të vazhdojë deri në lidhjen e kontratës nga procedura elektronike është në kundërshtim me nenin 36 “procedura me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës” i VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,

-Sipas procesverbalit të negocimit datë 02.03.2015, nuk janë paraqitur operatorët ekonomikë [REDACTED] dhe [REDACTED], nuk ka nënshkruar pjesëmarrësi në negocim, si edhe nuk ka gjurmë për negocimin e vlerës së kontratës, por thjesht citohet se u negocua për çmimin dhe nuk u ra dakord për uljen e çmimit, nga operatori ekonomik [REDACTED], veprim në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2015 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 66, pika 7 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”.

-Në dokumentet e tenderit, kriteret e veçanta për kualifikim “kapaciteti teknik”, njësia e prokurimit, është kërkuar që operatorët ekonomikë të paraqesin kontrata për furnizime të ngjashme të së njëjtës natyrë prej 40% të vlerës që prokurohet ...etj, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 28 “Kontratat e shërbimeve” ku citohet ...për shërbime të ngjashme të kryera, në këtë rast procedura është për prokurim shërbimesh dhe jo mallrash.

-Sigurimi i kontratës datë 02.03.2015, në shumën 102,754 lekë në shoqërinë e sigurimeve [REDACTED].

Kontrata është nënshkruar në datën 03.03.2015, me afat nga data 02.02.2015 deri në lidhjen e kontratës me mjete elektronike dhe vlerë mujore 856,262 lekë pa tvsh. Sigurimi i kontratës është kërkuar për 1 muaj. Kontrata ka zgjatur nga data 02.02.2015 - 28.04.2015, ose 3muaj dhe operatorit ekonomik [REDACTED], nuk i është kërkuar sigurimi i kontratës për periudhën 2 mujore.

➤ Në tenderin me objekt “Shërbimi i Ruajtjes dhe Sigurisë Fizike të Aeroportit të Kukësit”,

-Në dokumentet e tenderit, kriteret e veçanta për kualifikim “kapaciteti teknik”, njësia e prokurimit ka kërkuar që operatorët ekonomikë të paraqesin kontrata për furnizime të ngjashme të së njëjtës natyrë prej 40% të vlerës që prokurohet ...etj, në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 28 “Kontratat e shërbimeve” ku citohet ...për shërbime të ngjashme të kryera, në këtë rast procedura është për prokurim shërbimesh dhe jo mallrash. Fakt i cili flet se njësia e prokurimit harton dokumentet e tenderit apriori pa iu përshtatur objektit të prokurimit.

Konstatohet se operatori ekonomik [REDACTED] është shpallur fitues për 11 vjet radhazi në AAC.

B. Për Komisionin e Vlerësimit të Ofertave

7. P. H në cilësinë e anëtarit të KVO sepse, në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje Pajisje Kompjuterike për nevoja të AAC-së”,

-ka hapur ofertat në sistemin elektronik në datën e hapjes së tenderit më 04.08.2014 dhe vlerësimi ka përfunduar në datën 11.08.2014, pa respektuar afatin kohor prej 5 ditë, në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Kreu VI “Zhvillimi i procedurave kërkesë për propozim, blerja me vlerë të vogël, shërbimet e konsulencës, konkursi i projektimit” pika 1, germa “ç”.

sepse në tenderin e zhvilluar me objekt “Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike të AAC”,

- ka hapur ofertat në sistemin elektronik në datën e hapjes së tenderit më 10.03.2014, ndërsa vlerësimi ka përfunduar në datën 01.04. 2014, pa respektuar afatin kohor prej 5 ditë, në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Kreu VI “Zhvillimi i procedurave kërkesë për propozim, blerja me vlerë të vogël, shërbimet e konsulencës, konkursi i projektimit” pika 1, germa “ç”.

8. F. K në cilësinë e anëtarit të KVO, sepse në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje Karburante për nevoja të AAC-së” për vitin 2015

-Për dokumentet e tenderit të hedhura në sistemin elektronik në faqen e Agjencisë së prokurimit Publik, “kriteret e veçanta për kualifikim” të hartuara dhe miratuara nga autoriteti Kontraktor, ka paraqitur ankesë operatori ekonomik [REDAKTUAR] sh.p.k. datë 23.03.2015 prot 372/3, në datën 23.03.2015 prot 372/4 është pezulluar procedura për shqyrtimin e ankesës, dhe në datën 26.03.2015 i është kthyer përgjigje operatorit ankimes dhe është hequr pezullimi i procedurës.

Ankesa ka të bëjë me kundërshtimin e shtojcës 8, pika 2 e dokumenteve të tenderit “kriteret e veçanta për kualifikim”, ku nga AK është kërkuar që operatorët ekonomikë të kenë të paktën 3 pika karburanti brenda Tiranës dhe nga një pikë karburanti në çdo qark të vendit, gjithsej 14 pika karburanti. Ky kusht shkel të drejtën për konkurrencë të lirë të operatorëve ekonomik më të vegjël, sepse i përjashton ata nga marrja pjesë në konkurrim.

Përgjigja është dhënë nga komisioni i vlerësimit të ofertave, nga anëtarët e komisionit **M.Xh** dhe **F. K.**, të cilët kanë argumentuar se duhen pikat e karburantit në të gjitha qarqet, por nuk kanë argumentuar përse kërkohen të paktën 3 pika karburanti në Tiranë. (nuk ka nënshkruar **S. K.**).

Veprimet e mësipërme për përcaktimin e kriterëve të kualifikimit, janë në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenet 1 “Objekti dhe qëllimi i ligjit”, gjerat c, ç, d dhe dh, sepse, në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje Pajisje Kompjuterike për nevoja të AAC-së”, ka hapur ofertat në sistemin elektronik në datën e hapjes së tenderit më 04.08.2014 dhe vlerësimi ka përfunduar në datën 11.08.2014, pa respektuar afatin kohor prej 5 ditë, veprim dhe në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Kreu VI “Zhvillimi i procedurave kërkesë për propozim, blerja me vlerë të vogël, shërbimet e konsulencës, konkursi i projektimit” pika 1, germa “ç”.

9.D.O., në cilësinë e anëtarit të KVO, sepse në tenderin e zhvilluar me objekt “*Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike të AAC*”,

- kanë hapur ofertat në sistemin elektronik në datën e hapjes së tenderit më 10.03.2014, ndërsa vlerësimi ka përfunduar në datën 01.04. 2014, pa respektuar afatin kohor prej 5 ditë, në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Kreu VI “Zhvillimi i procedurave kërkesë për propozim, blerja me vlerë të vogël, shërbimet e konsulencës, konkursi i projektimit” pika 1, germa “ç”.

10.E. K., në cilësinë e anëtarit të KVO

11.E. H., në cilësinë e anëtarit të KVO, sepse në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje Veshje dhe Pajisje Specifike për Inspektorët e AAC-së”,

- nuk kanë vlerësuar kërkesat kualifikuese në mënyrë analitike në platformën elektronike (kriteret e përgjithshme ashtu edhe ato të veçantat-specifiket), por vetëm seksionet përmbledhëse, e konkretisht: “*Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit sipas shtojcës nr. 7 të DST*”; “*Kapaciteti Teknik dhe Financiar sipas shtojcës nr. 7 të DST*”; “*Kapaciteti Teknik sipas shtojcës nr. 7 të DST*”; “*Të tjera sipas shtojcës nr. 7 të DST*”. Kjo lloj hedhje ka ardhur si rezultat i punës së gabuar nga Njësia e prokurimit Publik. Në këto rrethana vlerësimi i tyre është “po” ose “jo”. Secila kërkesë kualifikuese analitike duhet të vlerësohet dhe ti jepen pikët më vete siç parashikojnë rregullat.

Në datën 14.07.2014 ora 11-00 në momentin e hapjes së ofertave në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, K.V.O., ka konstatuar se në sistem, është pranuar 1 (nje) ofertë.

-Operatori ekonomik [REDAKTUAR] sh.p.k. me vlerë të ofertës prej 1, 607,200 leke pa T.V.SH.

-kanë hapur ofertat në sistemin elektronik në datën e hapjes së tenderit më 14.07.2014 dhe vlerësimi ka përfunduar në datën 22.07.2014, pa respektuar afatin kohor prej 5 ditë, veprim

në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Kreu VI “Zhvillimi i procedurave kërkesë për propozim, blerja me vlerë të vogël, shërbimet e konsulencës, konkursi i projektimit” pika 1, germa “ç”.

-Komisioni i vlerësimit të ofertave pasi ka përfunduar vlerësimin në sistemin elektronik në datën 22.07.2014, ka vlerësuar si fitues operatorin ekonomik [REDAKTUAR] me vlerë 1,607,200 lekë pa tvsh (i vetmi i paraqitur në tender).

Operatori ekonomik [REDAKTUAR] nuk plotëson një nga kriteret e veçanta të kualifikimit të hartuara dhe miratuara nga Autoriteti Kontraktor pika 2.3 paragrafi 2, ku kërkohet: “operatori ekonomik ofertues (përveç produktit “dosje konferencieri”) të paraqesë certifikatë ISO 9001 dhe/ose ekuivalent me të, ku të garantohet cilësia e produkteve të kërkuara. Fusha e certifikimit, duhet të përkohë me kategorinë e produkteve që kërkohen”.

Kanë kualifikuar operatorin ekonomik pa plotësuar një nga kriteret e veçanta të kualifikimit të kërkuara nga autoriteti kontraktor dhe në këto kushte është shpallur fitues.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve” dhe VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu V. “Zhvillimi i procedurave”, pika 4/d “Hapja dhe vlerësimi i ofertave”, ku citohet sekomisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta që përmbushin kërkesat ligjore, administrative e kualifikuese, të përcaktuara në dokumentet e tenderit” dhe ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e komisionit **E.H dhe E.K.** Kryetari i komisionit të vlerësimit të ofertave **R.A.**, është shprehur kundër kualifikimit të këtij operatori ekonomik, sepse certifikata ISO 9001 nuk është paraqitur për artikujt “veshje punonjësish”.

Në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje Pajisje Kompjuterike për nevoja të AAC-së”,

E. H., ka hapur ofertat në sistemin elektronik në datën e hapjes së tenderit më 04.08.2014 dhe vlerësimi ka përfunduar në datën 11.08.2014, pa respektuar afatin kohor prej 5 ditë, në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Kreu VI “Zhvillimi i procedurave kërkesë për propozim, blerja me vlerë të vogël, shërbimet e konsulencës, konkursi i projektimit” pika 1, germa “ç”.

12.Y. S në cilësinë e anëtarit të KVO, sepse, në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje Pajisje Kompjuterike për nevoja të AAC-së”,

-ka hapur ofertat në sistemin elektronik në datën e hapjes së tenderit më 04.08.2014 dhe vlerësimi ka përfunduar në datën 11.08.2014, pa respektuar afatin kohor prej 5 ditë, në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Kreu VI “Zhvillimi i procedurave kërkesë për propozim, blerja me vlerë të vogël, shërbimet e konsulencës, konkursi i projektimit” pika 1, germa “ç”.

13. M.Xh në cilësinë e anëtarit të KVO, sepse në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje Karburante për nevoja të AAC-së” për vitin 2015

-Për dokumentet e tenderit të hedhura në sistemin elektronik në faqen e Agjencisë së prokurimit Publik, “kriteret e veçanta për kualifikim” të hartuara dhe miratuara nga autoriteti Kontraktor, ka paraqitur ankesë operatori ekonomik [REDAKTUAR] sh.p.k. datë 23.03.2015 prot 372/3, në datën 23.03.2015 prot 372/4 është pezulluar procedura për shqyrtimin e ankesës, dhe në datën 26.03.2015 i është kthyer përgjigje operatorit ankimes dhe është hequr pezullimi i procedurës.

Ankesa ka të bëjë me kundërshtimin e shtojcës 8, pika 2 e dokumenteve të tenderit “kriteret e veçanta për kualifikim”, ku nga AK është kërkuar që operatorët ekonomikë të kenë të paktën 3 pika karburanti brenda Tiranës dhe nga një pikë karburanti në çdo qark të vendit, gjithsej 14 pika karburanti. Ky kusht shkel të drejtën për konkurrencë të lirë të operatorëve ekonomik më të vegjël, sepse i përjashton ata nga marrja pjesë në konkurrim.

Përgjigja është dhënë nga komisioni i vlerësimit të ofertave, nga anëtarët e komisionit **M. Xh** dhe **F. K**, të cilët kanë argumentuar se duhen pikat e karburantit në të gjitha qarqet, por nuk kanë argumentuar përse kërkohen të paktën 3 pika karburanti në Tiranë. (nuk ka nënshkruar Suzana Kondo).

Veprimet e mësipërme për përcaktimin e kritereve të kualifikimit, janë në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenet 1 “Objekti dhe qëllimi i ligjit”, gjerat c, ç, d dhe dh, ku citohet se: *“qëllimi i këtij ligji është të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit, të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë të sigurojë trajtim të barabartë dhe jo diskriminues si edhe të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit”*.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Investimeve dhe Projekteve me Financime të Huaja dhe Shoqërive Publike.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R